

VENDIM
Nr. 126, datë 13.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 781, DATË 14.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KARAKTERISTIKAT TEKNIKE FUNKSIONALE TË PAJISJEVE
FISKALE, SISTEMIT TË INTEGRUAR TË KOMPJUTERIZUAR PËR TRANSFERIMET
PERIODIKE AUTOMATIKE TË DEKLARIMEVE FINANCIARE, SISTEMI I KOMUNIKIMIT,
PROCEDURËN DHE DOKUMENTACIONIN PËR MIRATIMIN E TYRE DHE PËR
KRITERET PËR PAJISJE ME AUTORIZIM, PËR SHOQËRITË E AUTORIZUARA PËR
OFRIMIN E PAJISJEVE FISKALE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 55 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 8.4: “Kontrolli periodik” e kreut 1 “Dispozita të përgjithshme”, të vendimit nr. 781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“8.4 Shoqëria e autorizuar, një herë në 24 (njëzet e katër) muaj, është e detyruar të kryejë kontrollin periodik teknik të pajisjeve dhe sistemeve fiskale. Tarifa e paguar për kontrollin periodik përfshin dhe tarifën e transmetimit, me nivel tavan jo më shumë se 4000 (katër mijë) lekë.

Tatimpaguesi siguron aksesin për kryerjen e kontrollit nga stafi teknik i kompanisë së autorizuar. Ngarkohet administrata tatimore të kontrollojë zbatimin e dhënies së shërbimit sipas këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha